

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" LIPA" SHPK**

Sot me daten 01/06/2022 (dymijë e njëzet e dy), ne ortakët themelues :

- **1 Z. Gëzim Kelmendi**, i biri i Nexhmedin, shtetas shqipëtar, i datëlindjes 21 Korrik 1986, lindur në Kosovë dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Letërnjoftimit (kartë identiteti) me Nr. I60721100I
- **2 Z. Sead Keljmendi**, i biri i Aziz, shtetas suedez, i datëlindjes 20 Gusht 1986, lindur në Mitrovicë, Kosovë dhe banues në Tiranë, disponues i letërnjoftimit (pashaportë), me Nr. 35207749

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " LIPA" SHPK.*

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "LIPA" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", shkalla 1, kati i katërt, apartamenti 11, me nr pasurie 5/280+1-11, në zonën kadastrale nr.8270, volumi 63 dhe faqe 121.

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e : eksport, import të mallrave ushqimore, alkolike, pijeve energjike, kafe, produkteve shtëpiake dhe pajisjeve për akomodim shtëpie. Aktivitete në fushën e shërbimeve në sektorin e ndërtimeve civile, objekte shërbimi dhe banimi, duke përfshirë shtrim pllakash, lyerje të objekteve të banimit, lyerje fasada, montim parketesh, montim të artikujve të mobilerisë, restaurim të objekteve të banimit, punime me gips, punime elektrike dhe hidraulike etj. Përpunim dhe tregtim të materileve të ndërtimit, hidrosanitare, elektroshtëpiake, konfeksione, prodhim dhe tregtim bojrash, rikonstruksione, shërbime dhe punime të ndryshme që vijnë në interes të shoqërisë.



Import-eksport të mallrave të ndryshëm dhe industriale , në fushën e prodhimit dhe tregtimit të mobilerisë , në fushën e turizmit,hotelerisë, në fushën e prodhimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore,dhe bujqësore industriale, në fushën e ndërtimeve, projekteve , prodhime duralumini etj.Kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar. Shoqëria në ushtrimin e katicitetit të saj do të marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare , dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj ekonomike.

#### NENI 4

#### KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "LIPA" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

1. GËZIM KELMENDI zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.
2. SEAD KELJMENDI, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

#### NENI 5

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

#### NENI 6

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. GËZIM KELMENDI, i cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.  
Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.  
Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.  
Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.  
Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve,statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### NENI 7

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se

gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim me një afat 30-60 pasi ortakët ngrenë pretendimet e tyre.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**"LIPA" SH.P.K**  
**GËZIM KELMENDI    SEAD KELJMENDI**

Gëzim Kelmendi

Sead Kelmendi

